Vera Istrefi: Në akuj digjem

☆ ☆ ☆

Vera Istrefi

Dy fjalë për vëllimin poetik

Vëllimi i tretë poetik i Vera Istrefit "Në akuj digjem", duket se ka përcaktuar e orientuar qartë rrugën artistike të poetes. Poezitë e këtij vëllimi, në fakt, janë krijuar fill pas

daljes në dritë të vëllimit të dytë të saj "Nënqeshje e ëmbël", por hezitimi për t'i botuar shpejt, kishte të vetmen arsye, mëdyshjen e poetes. Ajo hamendej, se këto krijime, do të ishin më të arritura se dy vëllimet e para, apo jo. Kjo dilemë, së pari, dëshmon vetëdijen krijuese të poetes, dhe së dyti, përgjegjësinë që ka ajo kur shkruan poezinë, misionin që mbart ajo, efektin që shkakton kur del në dritë etj. Krijuesi gjithnjë duhet t'i mendojë këto, po qe se do të gjykohet drejt.

Në këtë vëllim të Vera Istrefit, ka një përpjekje të qartë e të sukseshme, për të përgjithësuar idetë përmes një vargu të saktë e me një ritëm të brendshëm, që ngjiz mendimin poetik dhe e bën më të qartë qëllimin. Nga ana tjetër, Vera Istrefi, përmes vëllimit të tretë poetik "Në akuj digjem", provon edhe një herë, por tashmë në një nivel edhe me lartë, se jo vëtem ka ide, por di t'i shtjellojë ato për të arritur në gjykime e përfundime artistike përgjithësisht të drejta.

Fakti se Vera Istrefi del para opinionit të gjerë me vëllimin e tretë të saj, tregon për pasuri idesh, dhe larmi trajtimi. Ajo i përkët atij grupi krijuesish, të pajisur me aftësine për të observuar gjithçka, çdo gjë rreth saj, ku jeton e vepron. Në qënien e poetes lëvrijnë shumë ide, sepse ajo është një vëzhguese e imët e realitetit. Madje, ajo në asnjë rast nuk do të jetë pasive kundrejt gjithçkaje që ndodh brenda shoqërisë, pjesë e së cilës është edhe ajo vetë. Ajo e konsideron jetën si një dramë me një akt në të cilën poetja thotë:"Aktorë në të janë/të gjithë/ose një i vetëm". Prandaj Vera Istrefi ndalet edhe vrojton një cigare të hedhur në rrugë. E analizon atë dhe kërkon të zbulojë misterin prapa saj. Ec pothuajse pa asnjë qëllim shëtitores

së qytetit, por edhe ulet në një sofër grash, në të cilën nuk e gjen vetveten.

Një praktikë e tillë hulumtuese dhe vëzhguese të jetës së përditshme, e ka ndihmuar shumë poeten për të trajtuar një gamë të gjerë problemesh dhe për të përdorur mjete e teknika të shumëllojshme artistike.

Poezia e Vera Istrefit mund të veçohet në poezi meditative-filozofike, ku poetja rreket të gjykojë fenomenin shoqëror, kërkon të gjejë pozicionin e vet në këtë fenomen, mundohet që të imponohet në ndryshimin e dukurive sociale dhe të lërë gjurmë në të. Ajo kërkon me të drejtë që të jetë diçka në këtë jetë. Për poeten, heshtja e indeferenca kundrejt jetës dhe sfidave që ajo ka, nuk mund të pranohet. Jeta merr një kuptim, vetëm atëhere kur i imponohesh shoqërisë që të rrethon, kur ti vuan e gëzohesh, "qan e qesh" bashkë me të, kur përjeton të njëjtën veprimtari në jetën e përditshme.Vetëm këtu gjendet vetvetja sipas poetes.

Kur është e vetmuar, poetja ndjen nevojën e bisedës edhe me një zog. Prandaj ulet në tavolinë me vetveten dhe ndjen nevojën e komunikimit."…me ndjenja të paqarta/bashkë jemi lidhur/Edhe gjumi/S'na pushton të dyjave/njëherësh", thotë poetja Vera Istrefi në çastin kur e shikon veten të dyzuar dhe në ndonjë rast ku ajo hahet me vetveten, grindet me të, fle me të, por përsëri gjumi nuk i zë njëherësh. Grindja e mosmarreveshjet, por edhe domosdoshmëria e mirëkuptimi, kanë derën e hapur për nesër.

Grupi i dytë i krijimeve poetike në këtë vëllim, është poezia ku natyra ndikon shumë te bota shpirtërore e krijueses. Shpeshherë, ajo ndjen se ka një stuhi në shpirt,

stuhi e cila shkaktohet nga një dimër i akullt, nga një rigë shi që futet ngadalë nga flokët e qafa deri në palcë të shpirtit, po edhe nga pushi i plepave, apo bora e dimrit. "Dega e kumbullës/hesht mbi vazon e thjeshtë/thith ajrin e s'ngopem/me erën e luleve të saj/Dimri akoma s'ka ikur/dimri akoma s'ka ardhë/Si, ti, lulekumbull/ke çelur në këtë kohë, vallë?". Kështu shkruan Vera Istrefi, duke nënvizuar ndikimin që ka çdo gjë natyrore në shpirtin e saj, por edhe në universin e saj krijues.

Vëllimi i Vera Istrefit, "Në akuj digjem", pa dyshim është një arritje e çmuar e poetes në fushën e krijmtarisë poetike. Ajo, tashmë, ka fizionominë e profilin e vet në krijimin poetik. Besim R. Cengu

==========

*

Hutimin tënd
Si ta marr ?
Ç'të shashtisi, kalimtar ?
Flokët e dendur
A syri ulli?
Ti s'ke faj
Ka kohë
Që kam ndjerë
Nevojën e mbledhjes së flokevë.

*

Ti ec, kalimtar.
Me vete merr
Imazhin e mosbindjes

Dhe mbaj mend
Sa herë të kalosh këtu
Në këtë vend,
do të shohësh patjetër një vajzë
me flokë të shkurtër a të të gjatë

*

Shkujdesur në to,
Do të kalojnë gishta, erëra, mendime…
Jam e bindur.
Nuk do ta harrosh
Flokëkurorën time.
Hutimin tënd
Si ta marr?
Ç'të shashtisi, kalimtar?
Nga heshtja jote,
Shqetësimin me vete marr.

Pjesa e parë

1

Eja me mua, Drin,
Të vershojmë udhëve
S'di kush vuan më tepër,
A më pak nga ne.
Ty të ndryshojnë shtratin,
Mua më bëjnë pre.
Eja me mua, Drin,
Të vershojmë udhëve

T'i themi lamtumirë
Qetësisë së gënjeshtërt
Se të dy të lirë,
Këtu, jemi të tepërt.
Eja me mua, Drin,
Tëvershojmë udhëve.
Të vij unë tek ti,
Më duket e thjeshtë.
Por s'di cilin Dri të zgjedh,
Këtë fundvjeshtë.
Eja,
Drini i bardhë dhe i Zi
i bashkuar, eja tek une,
ti.
Të vërshojmë udhëve
Të dy

2

Më vjen gjumë
Edhe nata kur ka ikur.
Kapitem.
Natë e ditë pa gjumë.
Për mua
Nata vetëm dridhet,
E ditën,
Dridhem unë.

3

Ku jam?
Këtu

Apo aty?
Diku jam.
Por,
Nuk e di.
As këtu,
As atje
Jemi bashkë.
Ti dhe unë,
Unë dhe ti.
Vërtet!?
Të heshtim,
A të klithim?

4

Të humbur e fatkeqë,
Shëtisim bashkë,
Në shëtitoren e vetme të qytetit.
Pa dashur,
Pa ditur,
Pushtojmë hapat e njëri-tjetrit.
Të lumtur e fatkeqë
Shëtisim bashkë.
Pa dashur,
Pa ditur,
Në shëtitoren e vetme
Të qytetit.

5

Trëndafili,
sado i bukur që të jetë

pas vyshkjes,
le veç gjembat.
Shtrëngoj fort
Duart e femijëve të mi,
E lë pas hamendjet.

6

Rrekem të mbaj rob
Një çast,
I cili më shkakton
Një ndjesi të akullt,
Transparente.
Në këtë çast,
Lidhje të panumërta,
Realizohen.
Në paqartësi,
Më pushtojnë zhurmat
E ardhura nga jashtë

7

Erë qepësh të njoma
Vijnë duart e tua
Ndërsa trupi
Aromë epshore
Jargaviten burrat
E harrojnë të hanë
Ushqimin e servirur
Nga ti

8

E vërenjtur
Nën rroba të zeza
Të dridhet trupi, vejushë.
Diçka
Për të të ngrohur
S'të ofron askush.
Nëse të nesërmen,
prapë do të jetë kështu
mos ardhtë kurrë për ty
mëngjesi

9

Ma tha lypsarja në rrugë;
-Të gjatë paq rininë.
Loti më mbeti në sy,
duke rrëshqitur jo faqeve,
por shpirtit të plagosur.
Ma krypi plagën,
lypsarja në rrugë

10

Sivjet,
Bora duket se ka frikë
Nga nxehtësia
E tendosjes së nervave të njerëzve.
Në pritje të saj,
Fsheh zjarrminë time

11

Tek ju,

Do të hyjë vargu im
Nga dritarja,
Nëse ia mbyllim portën.
Nuk do të dorëzohet,
Pa ju imponuar,
Qoftë edhe një rrokje,
Do të takoni
Veten dhe mua.

12

Në sofrën tuaj të madhe,
Po të afrohem, e di,
do të më cysni si macen,
poshtë sofrës me bezdi.
Një lugë e rënë në tokë,
një nemur në erë,
Të mjera.
Sidoqoftë,
përherë mbetem "verë".
T'ju shoh nga lart, unë dua,
S'ka rëndësi, ju mua.
Për këtë arsye të thjeshtë,
Ju, mbeteni «mbarimvjeshtë ».

13

Funddimri.
pragpranvere.
Ndiej ngrohtësi nga brënda.
Nga funddimri,
Më ngjethet trupi.

Nga pragpranvera,
vërshojnë brënda meje,
përrenj
dhe mbeten ujëvara,
që s'dijnë ku të derdhen.
Kërkoj me ndjesinë time
Muzikën e Shvartcit,
a të Verdit.
Moxarti ,më ushton në veshë
Dhe në ujëvarën time,
një pulëbardhë,
kërkon pak ujë të qetë.

14

Zorinë
Për zor.
Sose,
u sosshin.
Mbarime,
u mbarofshin.
Kështu tek- tuk,
mbase më shpesh,
thuhet për vajzat,
pas dyshes në rrjesht.
Unë
Kam në mëndje
Sihanen,
Lulemirën,
Floridën.
Kërkoj ndryshimin.

15

Kur të kalosh, ti, rrugës time,
mbaj vesh.
Aty është zëri im prej fëmije,
e qeshura pa kufi.
Edhe të qarat, janë aty.
Zhurmshëm,
hapat e mij do të zgjohen.
Ka kohë që nuk ndihen.
Ke për të parë një vend,
ku jam ndalur,
bashkë me frikën,
për të hequr një dhëmb.
Aty do të jetë,
drithërima e shprehjes
së dashurisë së parë .
Edhe lotët,
po aty.

16

Kur të kalosh, ti, rrugës sime,
do të xhelozosh,
e di,
por, aty e deri këtu,
kemi qenë veç une e ti.
Kur të kalojmë bashkë,
s'do të kemi kohë të kujtojmë,
se sa jemi dashtë.
Femijët,

Do të na tërheqin
Të luajnë,të qeshin,të qajnë,
si unë.
Dhe unë e ti,
do të duhemi më shumë.

17

S'do të më mjaftojnë ditët,
Për t'u sosur dhimbja,
Për humbjen e foshnjes time
Të parë.
Unë
S'kisha mbushur
të njëzetat.
Foshnja,
Shkatërruar ish,
Brënda meje.
Heshtje në lotë,
Mbrëmjeve të vona,
E mëngjeseve të hershme.
Zërat e fëmijëve,
Më ftojnë,
Në monotoninë e jetës,
Më imponohen natyrshëm,
Si bijtë e nënës.
Ngashërimi ,
Mbetet diku,
Brënda meje,
Në pritje
Të ndonjë mbrëmje të vonë,

E të ndonjë mëngjesi,
Tepër të hershëm.

18

Në shpirt,
Më fle dhimbja.
Në zemër diçka tjetër,
Më shumë se neveria.
Për ty, ndjenja e vjetër,
Herët, apo vonë?
Kur do të ndodhë,
Që përballë të jemi,
Unë dhe ti,
E njëra-tjetrën
Ta shohim në sy?
Ti më fshihesh,
Ndryshe, s'ka se si

19

Më rëndon mbi qerpikë,
Pushi i rënë nga plepat,
Parregullsisht.
Vshtrimi më humb qartësinë.
Ecjen time, vazhdoj.
Edhe rrapëllime qepallash.
Shkund flokë e qerpikë,
Nga pushi i plepave
Dhe ec mes tij.

20

Nuk jam ëngjëll.
Kujtimet nuk më janë
Vetëm të fjetura.
ëndrrat,
Varur më janë qerpikve.
Në heshtje lyej qerpikët
Me rimel të trashë,
Blu.
Ndërsa kujtimet struken,
Sa aty, këtu.

21

Tok me foshnjen,
Përkund ëndërrat e mia,
Në djepin e drunjt.
Shpresa e ankthi,
Bashkë!
Përkund
Foshnjen ta zërë gjumi,
E ëndërrat të heshtin.
Më fle trupi
Mbi shtrat mendimesh

22

Çdo vit pyes veten:
Si vjen pranvera
Në këto rrugë?
Ikin pranverat,
Edhe vitet,
Bashkë me to.

Unë i jetoj
Dhe s'i ndiej
I jap vetes të drejtë,
Se asnjëherë mbi këto rrugë,
Nuk shoh diçka të blertë.

Pjesa e dytë

1

Ditët që do të vijnë,
Kur të kalojnë,
Me hapat e hekurt,
Do të ndalen të dëgjojnë,
Klithmat e dhimbjes time.
Dhimbja ime,
Vetëm do të heshtë,
E heshtazi do të gjëmojë
Mbi dhimbjen time,
Mundet që atë ditë,
Të shihet një karafil,
Ose…
I gjakut, një cërril.

2

Jam lot në sytë tuaj,
Nuk rrëshqas poshtë tyre,
S'jam lot që fshihet,
Me një veprim të dorës.
Lot gëzimi e hidhërimi.

Lot mpleksur në dhimbje.

3

Këtë mëngjes,
Të gjithë duken të fjetur.
Dhe mjergulla mbi qytet,
Fjeti.
Ndërsa, unë tërë natën,
Me dorën te djepi.

4

Mos ma harro dritaren ,
Trumcak.
Eja përsëri.
Bashkë, do të flasim ngapak,
Se merremi veshë,
E di.
Nëse do,
Eja dhe në pranverë,
Pranë dritares do jem,
E heshtur si përherë.

5

Bryma në lëndinë
Më ka pushtuar,
Qënësia-nënë.
Kam një ngrohtësi,
E të vetmin mendim.
Kjo ngrohtësi ime,
brymën e shkrin

6

Mes perdeve të tylta,
Natyra më fal,
Qindra rreze përtëritesë,
Që mblidhen të tëra,
Petal,
Mbi fytyrën e foshnjes time.

7

Qetësirat e netëve,
Notojnë detërave të trazuar,
Në shpirtin tim.
Dhe s'ndalen.
Se asgjë tjetër s'dinë.
Veçse të notojnë.
Qetësirat e netëve,
Tretur janë,
Fortunave të shpirtit tim.

8

Trupi yt,
Në akuj digjet.
Duart,
Mbi prush të merdhijnë.
Me të qara,
Luan simfoninë.
Mes belbëzimesh,vallëzon,
Jeta.
Une të tërheq

Për dore,
Nga vetja.

9

Nuk bien lotët,
Por ritmojnë zhurmshëm,
Lotët e dhimbjes.
Hesht, heshtja.
Në zemër ther,
Pamundësia për të folur.
Shpirti stonon,
Në vajin e brëndshëm.
Buzët qesin,
E mërzia varet,
Në qosh të tyre.

10

Zhurmore,
Lotët e mij në rrokullisje.
Përcëllues.
Rrëshqasin poshtë në tokë,
E ngrihen me tërbim.
Zënë një vënd të kotë,
Diku në syrin tim.

11

Dhimbjet tuaja rrëke,
Mblidhen në detin tim
Të dëshpërimit.
Heq copëra nga shpirti,

T'i bëj vënd qetësimit

12

Kam menduar
Duke kujtuar porositë e tua
Kam shkruar për ty.
Të kam përshëndetur,
Ngrohtë, në rrugë,
Ashtu, thjesht.
Nuk e dija,
Se pikërisht, thjeshtësia ime,
Do të tërbonte mendimin tënd,
Për mua.
S'ka rëndësi
Unë do të vazhdoj të mendoj
Të shkruaj
Përshëndetja për ty
Është tretur në qënien time
Ashtu si për herë
E thjeshtë
S'ka si të bëjë bujë
Është delikate
Si vetë unë

13

Është dramë jeta
Me një akt
Është e pafund
Aktorë në jetë janë
Të gjithë

Ose një i vetëm
Gjithçka tjetër
Mbetet pas kuintave.
Suksesshëm kush luan
Del i kërusur.
Pafundësia e të vetmit akt
Tretur nuk ka.

14

Rradhërradhë,
Janë vënë ditët e netët
Në rrugët e qytetit tim.
Shikimet dhe bliret,
Sundojnë mbi to.
Nuk e di,
Të qaj, a të qesh,
Për t'u nisur,
Tek i pres.

15

Mbeten rrugëve,
Dashuritë.
Të braktisurat.
Të fshehurat.
Të vjedhurat.
Të shtirurat.
Zabtojnë familjet.
Ku mbeti dashuria e vërtetë?

16

Dehur, qenkam sonte.
Era, qielli, toka…
Kërkoj,
Të mbledh ciflat
E gotës së thyer.
Kam veshur
Kepucë të veçanta,
Nga frika e kristaleve.
Etje kam,
Për dehje.

17

Koha,
U suall dinakërisht me mua.
Edhe përkëdheljet e saj,
Ishin dinake.
Mëkatarët,
Vrapojnë pas kohës
Dhe koha,
I zhyt në marrëzi të tjera.
Vuajtja ime,
Është shumëngjyrëshe
Kam frikë nga e kaluara.
I zgjas dorën vetes
Dhe i themEja.
Na pret e ardhmja!

18

Iki shpesh nga vetja,
Ngaqë nuk mbush dot,

Zbrastësinë e brendshme.
Copëzuar më është jeta.
Në ikje,
Si e krisur, shtrëngoj në gji
Padjallëzinë.
I jepem harresës.
E lodhur, tërheq flokët.

19

Unë dhe vetvetja,
Kam diçka të shtrenjtë.
Në tavolinë,
Ulemi çdo mbrëmje.
E gënjejmë njëra - tjetrën,
Me ngopje kafshërore,
Prej shuarje urie.
Me ndjenja të paqarta,
Bashkë jemi lidhur.
Edhe gjumi,
S'na pushton të dyjave
Njëherësh.

20

I vetëm pa ty
Dridhem si gjethja
E ahut në vjeshtën e vonë.
Pranë meje kur je
Jeshilin e gjithë drurëve marr.
Kristalet e pikave të vesës
Mësojnë ato fjalë

Që dua të them ty.
Askush tjetër…
As drurët…
As zogjtë
As fëshfëritja e gjetheve.
S'dua të përfundojë
Asnjëherë
Takimi ynë i pafajshëm
E hyjnor,
Kur sytë tanë
Gjithçka thonë…

21
U mësova me dhimbjen e plagëve,
e therjen në zemër.
Stuhinë e ëndërrave,
e mposhta.
Në fitore e humbje,
Njëlloj,
Veçse jam femër.

22
Gonxhe prapa gjethes.
Syri nën qerpik.
Frika në zemër.
Me të njëjtin emër.
Krejt tjetër është,
ajo që dua,
nga ajo që ndiej…

23

Nën re,
unë do të jem,
më e bukur.
Më e re.

24

Tjetërsoj ndihem,
kur pikat e shiut,
depërtojnë flokët e mij.
E ndonjë syresh,
Rrëshqet poshtë supeve
Dhe e ndiej në trup.
Harroj ku jam.
Harroj ku vete.
Orkestër e tërë,
Organet e mia.
Lagështi e shiut,
Ujit gonxhet,
Që mbetur kanë pa çelur,
Në kaq vite.
Mundohem të largoj
Pikat e shiut
Nga qerpikët.
E kotë…
Bashkë më mblidhen të tëra,
Në mjekërr.
E vrullshëm më pikojnë në gjoks,
Në zemër.
Presim gonxhet e paçelura,

Hapkë e kohes,
Rrezet e diellit.

25

S'di ç'stinë,
Çmenden mendimet e mia.
Në pranverë?
Jo!
Aroma e luleve,
Më fal qetësinë.
Në verë?
Nxehtësia më struk,
Në shtëpi me hijen.
Vjeshta?
Veç dëshirës për fruta,
Asgjë tjetër.
Edhe dimri,
M'i ngrin mendimet.
Ç'është kjo stinë,
Që s'di kur vjen,
E kur shkon?!

26

Tej vetes time,
Është pendimi.
Etalon,
Për matjen e mallit,
S'kam.
Ëndërronte mëndja,
Ë ëndrra fundoset në jetë.

Tej vetes time,
Është pendimi.

27

Me panjat delikate,
Miqësi kam zënë.
E di.
Se rreth tyre prehen,
Dashuri të hershme,
E të vona.
Edhe lot.
Psherëtima e jetës,
Po aty.
Me panjat delikate,
Miqësi kam zënë.
Rreth tyre,
Asgjë veç heshtjes,
S'kam lënë.

28

Pëlhura e merimangës,
Ka zaptuar qoshen e murit,
E shëndrit,
Nga rrezet e para të mëngjesit.
Në të,
Më janë ngatërruar frazat.

29

Dega e kumbullës,
Hesht mbi vazon e thjeshtë

Thith ajrin e s'ngopem
Me erën e luleve të saj.
Dimri, akoma s'ka ikur.
Dimri akoma s'ka ardhë.
Si, ti, lulekumbull,
Ke çelur në këtë kohë, vallë?

30
Të huaj,
Nuk ka mes nesh,
Në këtë qytet të vogël.
Në pritje të borës,
Bashkë prapë,
Në këtë dimër të thatë!

31
Ajo që mund t'i themi
Njëra - tjetrës,
Qëndron jashtë nesh.
Shenjat janë farë të qarta.
Me to,
Mund të sajojmë një përshesh,
Pa shije.
As të ëmbël, as të thartë.
E njohim rrugën, që do të ketë
Miqësia jonë.

32
Erë .
Shi.

Vetëtima.
Koka me oshëtin.
S'di ku është stuhia,
Brënda a jashtë kokës time.
Dua t''i largoj stuhitë.

33

Shoh jashtë dritares
Shkëlqimin e rrezeve të fundit,
Të diellit të sotëm.
Cigare të rastit
Të ndezura në rrugë,
Shoh.
Pi kafenë, tek jam e pazonja,
Të nxjerr një fjalë.

34

Ti nënqesh,
Ose me saktë
Për xhaketën time
Të dalë boje
E mirë!
Në fund të fundit
Unë do të kem
Kujt t''i them lamtumirë
Ndërsa ti
Do të lësh pas
Vetëm një garderobë
Jo të lirë.

35

Angështia e pluhuri,
Po zaptojnë hapësirën
Pas mornicave të dimrit
Djerësij
Ndiej lodhjen pa fund
Pa nisur ende dita
Vërtet,me aq padurim
Këtë mot prita?
Përmbahem
Kështu mendoj
Kur mpleks
Gërshetin në mëngjes
Dhe e shpleks
Në mbrëmje.